



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КОСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jediniça Org.Unit	SP-02
Nr./Faqe/s Br./Stranica No/Pages	01
Nr./Prot. Proj./Prot. Prot.No	1978-3/24
Data Datum Date	12.05.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.04.2025
REFERENC-Ë:	1978/25 - ZSP 2025 ; ARPL
PËR/ZA/TO:	Z. Fisnik SHEHOLLI, Çagllavicë, K. Graçanicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtor i ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim Ujor ,

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. të protok. 1978/25, nga pala, Z. Fisnik SHEHOLLI nga Podujava, për kalim mbi pronë ujore, K. Graçanicë dhe ka vendosur si në Vendim, Pëlqim Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë: 23.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PELQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palëve: Z. Fisnik SHEHOLLI për **PËLQIM UJORË**, me Nr. prot. 1978/25, për kalim mbi pronë ujore për çasje në pronë, Z.K. Çagllavicë, K. Graçanicë;

Nën Kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet për kalim me urë mbi pronën ujore, në pikën me koordinata P_1 ($X= 7\ 512\ 192, 245$; $Y= 4\ 719\ 857.924$), P_2 (7512192.317 ; $Y=4\ 719\ 855.422$); P_3 ($7\ 512\ 195.548$; $Y=4\ 719\ 858.016$ dhe P_4 ($7\ 512\ 195.619$; $4\ 719\ 855.517$) në pronësi të palës, Z. Kad. Çagllavicë, K. Graçanicë, P-73414073-00919-2, në bazë të dokumentacionit investivo-teknik, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe si i tillë ruhet nga pala;
2. Kalimi mbi pronën ujore, sipas projektit, respektivisht 2.5 m' në vendin e paraparë si në situacion;

3. Pala duhet të ketë parasysh se, kalimi i lire nuk do të thotë se prona mund të kaloj në pronësi të palës;
4. Në pjesën tjetër të pronës ujore, nuk lejohet ndërtim tjetër, apo çfarëdo llojë aktiviteti tjetër, që nënkupton shfrytëzim;
5. Pëlqimi vlen vetëm për kalim mbi pronën ujore;
6. Pala duhet të ketë parasysh, se me rastin e hartimin e Planit të Menagjimit të Resurseve ujore, nëse do të vendoset për kushte tjera, ndryshe nga rasti, duhet ti adaptohet atyre, sipas kërkesave të nevojshme, pa ndonjë kompensim;
7. Pëlqimi ujon ka afatin kohorë prej 2 viteve, nese deri atëherë nuk e ka filluar ndërtimin.

Arsyetim

Pala, Z. Fisnik SHEHOLLI, fsh. Çagllavicë, K. Graçanicë ka bërë kërkesë, me nr.prot.1978/25, lidhur me kalimin mbi Pronën Ujore, për çasje në pronë private, me nr. P-73414073-00919-2. Kërkesës i ka bashkangjitur: Faturen e pagesës, me rastin e aplikimit, nr.000321, Certifikatën e pronësisë, për ngastren, P-73414073-00919-2; Plani i situacionit me përpjesë të lexueshme 1:1000, ashtu siq kërkohet me "U.Ad. MMPH, 03/2018 për procedurat për leje ujore"; plani i situacionit i punuar nga person i licencuar i lëmis përkatëse, Nr i licences 74, nga "Geo Service Engineering". Certifikata e kompanise hartuese " FST Engineering" sh.p.k. Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit tekniko investivo të dorëzuar në 3 kopje dhe një CD, është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 1978/25 - ZSP- 2025 Datë: 23.04.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Graçanicë;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI